



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 09, datë 20.01.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 447, SERIA T19, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SANG 1” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 106, DATË 26.06.2019.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 5, germa “a”, nenit 6 dhe nenit 7 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 58, datë 18.04.2017, pikës 5.1 dhe pikës 5.2 të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 97, datë 17.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 9/8 prot, datë 20.01.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k.,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., është mbajtëse e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nr. 447, seria T19, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 106, datë 26.06.2019.
- Nga këqyrja e ekstraktit të QKB-së së shoqërisë, ka rezultuar se janë shitur 79% e kuotave, në shkëlqje të parashikimit të pikës 5.2 të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku përcaktohet se i licencuari duhet të marrë autorizimin e ERE-s përpara se të ndryshojë aksionarin apo ortakun që kontrollon interesat.
- Shoqëria nuk ka kthyer përgjigje kërkesës së ERE-s për faktin se si ka vepruar me zbatimin e detyrimeve ligjore për të marrë autorizimin e ERE-s për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë.
- Në nenin 42, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe në pikën 5.1 të licencës nr. 447, seria T19, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e

Bordit të ERE-s Nr. 106, datë 26.06.2019, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë.

- Në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. Nr.58, datë 18.04.2017, me fillimin e procedurës për heqjen e licencës, shoqëria “SANG 1” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer për llogari të ERE-s pagesat rregullatore për vitin 2020, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Me vendimin e Bordit Nr. 171/2020, ERE ka miratuar pagesat e rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, për vitin 2020. Vendimi i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 19.11.2020 dhe sipas pikës 3 të këtij vendimi, të licencuarit duhet të shlyejnë këtë pagesë jo më vonë se 30 ditë nga botimi në fletoren zyrtare të këtij vendimi. Për këtë detyrim shoqëria “SANG 1” sh.p.k., është njoftuar dhe me shkresën e ERE-s nr. 1226/130 prot, datë 27.11.2020.
- Nuk rezulton që shoqëria “SANG 1” sh.p.k., të ketë shlyer pagesën e rregullimit për vitin 2020, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ndaj me marrjen e njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës, ajo duhet të shlyejë për llogari të ERE-s këtë pagesë.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 447, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 26.06.2019.
2. Shoqëria mund të paraqesë argumentet e saj me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., duhet të shlyejë për llogari të ERE-s pagesën rregullatore për vitin 2020 për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare